

## AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

“ALLES DEUTSCH” Shpk

Sot më date 26 / 05 2020, ne të nënshkruarit:

- **z.nj. Natasha Shahu**, i datëlindjes 24.04.1957, lindur ne Dhoresh Shqipëri dhe banues në Tiranë,
  - **z.Arnold Meleqi**,i datëlindjes 02.02.1995 ,lindur në Kruje Shqipëri dhe banues në Tiranë,
  - **z.Granit Kërkhaliu**,i datëlindjes 02.05.1981 ,lindur ne Kukës Shqipëri dhe banues në Tiranë,
- shprehim vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**ALLES DEUTSCH**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

### 1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**ALLES DEUTSCH**” shpk, nga këtu e mëposhtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

### 2. Ortakët themelues

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

- 1 **z.nj. Natasha Shahu** zoteron 33.33 % te kapitalit themeltar me vlerë 500.000 (peseqindmije ) leke
- 2 **z.Arnold Meleqi** zoteron 33.33 % te kapitalit themeltar me vlerë 500.000 (peseqindmije ) leke
- 3 **z.Granit Kërkhaliu** zoteron 33.34 % te kapitalit themeltar me vlerë 500.000 (peseqindmije ) leke

### 3 Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **ALLES DEUTSCH**” sh.p.k. do të jetë:

- Tregetim te materialeve ndertimi, elektrike , hidraulike, mallra ushqimore , fruta perime,materiale pastrimi ,higjenosanitare, mobilje,elektroshtepiake,hidrosanitare metrazhe,vajra lubrifikante,pjese kembimi per automjete,kancelari
- Import – Eksport te mallrave ushqimore ,kimik, industrial ,automjete,bimesh medicinale.

- Import –eksport dhe tregeti i cdo produkti qe nuk eshte ne kundershtim me ligjet nderkombetare.

#### **4 Selia e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë **ALLES DEUTSCH"sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Rr Nozllaku ,njesia administrative Yrshek- Tirane,zona kadastrale nr 3865 .

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

#### **5 Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë 20 (njezet) vjeçare, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afat i përmendur në pikën 1 të këtij nenit mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakut të vetëm, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

#### **6 Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare "**ALLES DEUTSCH" sh.p.k.** është 1.500.000(njemilion e peseqind mijë) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

#### **7 Ortakët e shoqërisë**

Ortakët e shoqërisë ushtrojnë kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve.

#### **8 Drejtimi dhe Administrimi**

Shoqëria drejtohet nga Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë "**ALLES DEUTSCH" sh.p.k.** është z. **Granit Kérxhaliu**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**ALLES DEUTSCH**” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 9 Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

### Themeluesit

Natasja Shaluu



Granit Kërkhaliu

Arnold Meleg:



